



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ prot.

Tiranë më, _____, _____, 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data *30.11.2023*

Drejtuar: **“Nexhmedin Sadiku” Pf**

Procedura e prokurimit: **“E Hapur e Thjeshtuar”**

Numri i procedurës: **REF-84342-10-19-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje paisje lodra, paisje rekreative dhe element Urban”.**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.87, datë 23 Tetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Nexhmedin Sadiku” Pf

L71503044S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **4 746 810** (katër milion e shtatëqind e dyzetë e gjashtë mijë e tetëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH.**

2. “SARK” Shpk

K52531415H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **4 595 000** (katër milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) **lekë pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “SARK” Shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K52531415H

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

1. Autorizimi i prodhuesit për kompaninë SARK nga kompania Metod Park fillon nga data 15.10.2022 deri në gjashtë muaj me përcaktimin që më vonë mund të rinovohet. Nuk është paraqitur në SPE autorizimi i rinovuar i prodhuesit në të cilin të jetë e përfshirë periudha e zhvillimit të procedurës duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.5.
2. Operatori ekonomik “SARK” shpk ka paraqitur katalogun e prodhuesit Metod Park por dokumenti është paraqitur i papërkthyer. Në njoftimin e kontratës përcaktohet që gjuha e ofertës është : Shqip. Në udhëzimet për operatorët ekonomike përcaktohet në Seksionin 1 Udhëzime për operatorët ekonomike, Seksioni B “Përgatitja e ofertave” pika 2 “Gjuha e ofertës” përcaktohet më poshtë:

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.

Pra sa më sipër katalogu duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe si gjuha e përcaktuar e ofertës.

3. Ka paraqitur autorizim prodhuesi nga UKA shpk Kosovë por katalogu i paraqitur nuk specifikon mallrat me të cilat do të ofertohej duke bërë të pamundur krahasueshmërinë e tyre specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Sikundër përcaktuar në pikat 1,2,3 operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.6.

4. Në pikën 2.3.4 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik përcaktohet sa më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë nga prodhuesi certifikatat e mëposhtme:

- **ISO 9606-1:2018** mbi kualitetin e saldimeve, të akredituar nga institucione shtetërore vendase ose të huaja, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).
- **FSC-STD-40-004 V3-0** mbi kualitetin e lëndës drusore, të akredituar nga institucione shtetërore vendase ose të huaja, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).
- **S SH EN: 1176-1: 2017** mbi përdorimin e pajisjeve në ambiente të jashtme dhe të sigurta në përdorimsipas normave EU.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik "SARK" shpk konstatohet se nuk janë paraqitur në plotësim të këtij kriteri **ISO 9606-1:2018, FSC-STD-40-004 V3-0 dhe S SH EN: 1176-1: 2017** duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4.

5. Në objektin e përcaktuar në ISO 9001-2015 nuk është i përfshirë objekti i prokurimit duke mos plotësuar Kriteret e Vecanta për Kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.2
6. Në objektin e përcaktuar në ISO 45001-2018 nuk është i përfshirë objekti i prokurimit duke mos plotësuar Kriteret e Vecanta për Kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.3

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "**Nexhmedin Sadiku**" Pf, me adresë: Tiranë kashar rruga; "Egnatia", ndertesa nr.10, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **4 746 810** (katër milion e shtatëqind e dyzetë e gjashtë mijë e tetëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH.** / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga "Xhezmi Delli", Godina nr.20, Tiranë me nr kontakti 0677406281 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej (_____) siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JOX

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Anisa Ruseti